



**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 47, Datë 07.03.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË SHOQËRISË OSHEE SH.A PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të neneve 16; 20, gërmat “a” dhe “e” dhe nenit 75 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 9 dhe 10 të Rregullores për Procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 135, datë 06.09.2017; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 07.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e Planit të Investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a për vitin 2018,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën me nr. 808 Prot, datë 15.01.2018, OSHEE sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s, Planin e Përditësuar të Investimeve për vitin 2018.
- Grupi i punës i ngritur me urdhërin nr. 14, datë 01.02.2018 të Kryetarit të ERE-s, shqyrtoi aplikimin e dërguar nga shoqëria OSHEE sh.a., duke konstatuar se Plani i Investimeve për vitin 2018:
  - Paraqitet i ndarë sipas kategorive dhe zërave të shoqëruara me vlerat përkatëse financiare si dhe një relacion të përgjithshëm teknik për investimet që priten të realizohen gjatë vitit 2018;
  - Përmirëson shërbimin e furnizimit me energji elektrike, të konsumatorëve në sistemin e shpërndarjes;
  - Bazuar në relacionin e dërguar nga OSHEE sh.a. do të ketë impakt në uljen e humbjeve teknike edhe jo teknike;
  - Ndikon në mbajtjen e parametrave teknik të furnizimit me energji elektrike të parashikuara dhe në Kodin e Shpërndarjes së energjisë elektrike;
  - Plotëson dhe përmirëson sistemin e matjes në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike;
  - Parashikon periudha kohore të zbatimit të investimit për ndërtimet apo reabilitimet e investimeve përkatëse.

- Mbetet problematik zbatimi i rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve, i cili duhet të shoqërohet me:
  - informacion lidhur me kapitalizimin e investimeve të realizuara 2017;
  - informacion të plotë lidhur me investimet e realizuara nëpërmjet Partneritetit Publik Privat, kontratat dhe detyrim/realizimet;
  - informacion mbi financimin dhe burimin e këtyre financimeve për realizimin e planit të investimeve për vitin 2018 si dhe periudhat e shlyerjes së këtyre investimeve;
  - Planifikimet e investimeve për të parandaluar problematikat e evidentuara, si në rastin e N/St Ballsh dhe prodhuesve të lidhur në N/St Lozhan;
  - Miratimin e Këshillit Mbikqyrës për planin e investimeve për vitin 2018.
  
- Në zbatim të nenit 75 të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE ka detyrimin të miratojë planin e investimit për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, i cili përcillet në ERE për mriatim, pas hartimit, nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Planit të Investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a për vitin 2018.
2. OSHEE sh.a. të depozitojë pranë ERE-s dokumentacionin dhe informacionin e munguar sipas konstatimeve në këtë vendim.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
ANËTAR I BORDIT TË ERE**

**Erjola SADUSHI**